

V E N D I M
Nr.461, datë 3.10.1994

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ato që do të caktohen, me datë fillimi deri më 31.12.1994 (përfshirë edhe këtë datë) të ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, të parakohshëm, për vjetërsi shërbimi, për vjetërsi shërbimi për raste të veçanta, për merita të veçanta, invaliditet të grupit I, II dhe III ose invaliditet të plotë që janë ndërmjet kufirit 1920-2050 lekë në muaj, bëhen 2200 lekë në muaj.

b) Pensionet 2051 lekë e lartë shtohen me 150 lekë në muaj.

c) Pensionet e mësipërme, kur janë nën kufirin 1920 lekë në muaj, shtohen me shumën 280 lekë në muaj.

ç) Pensionet familjarë dhe pensionet e invaliditetit të grupit IV ose invaliditetit të pjesshëm rriten në masën 15 për qind.

2. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”, dhe nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ato që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1994, ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, invaliditetit të grupit I dhe II që janë në kufinjtë 528-700 lekë në muaj, bëhen 700 lekë në muaj.

b) Pensionet e mësipërme, kur janë nën kufirin 528 lekë në muaj, shtohen me 172 lekë në muaj.

c) Pensionet familjare dhe pensionet e invaliditetit të grupit III rriten në masën 35 për qind.

3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore të bëjë ndryshimet e mësipërme dhe të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

4. Efektet financiare prej 88.8 milionë lekësh në muaj përballohen nga buxheti i shtetit. Për këtë në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore gjer më 31.12.1994 shtohen 266.4 milionë lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.10.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi